



REPUBLIKA E KOSOVËS

Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Partecipim: 01.03.2017

KOMUNA VUSHTRRI

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel. 028 871 824

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me Nr.03/L-040, si dhe Njoftimit të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me Nr.09-007-92 të datës: 17.10.2016, lidhë këtë:

MARRËVESHJE ME PARTICIPIM Për projektin Pemëtari

E përpiluar në mes të:

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Bajram Mulaku në njërën anë në cilësinë e subvencionuesit, dhe
2. Grupit të përfituesëve të pemëtarisë që kanë participuar për projektin e lartshënuar të cilën e përfaqësojnë me autorizim:
 - Gani Binaku nga fsh.Pantinë me Nr.personal:1001771848
 - Sejdullah Shala nga fsh.Akrashticë me Nr.personal:1233254467
 - Safet Kelmendi nga fsh.Dolak me Nr.personal:1004135381

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e plantacioneve në pemëtari.

Neni 2

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfituesëve të pemishtes të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfituesëve për realizimin e projektit Pemëtari, në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionues kryesor i projektit.

Neni 3

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesëve të pemishtes për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej 8,668.00€.

Neni 4

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si investitor kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej 20,000.00 €, ndërkaq që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është 28,668.00€

Neni 5

Obligimet e Komunës

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit e pemishtes të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

Neni 7

Obligimet e përfituesit

- 7.1 Përfituesi është i obliguar të paguajë shumën prej 394€ në llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrrisë.
- 7.2 Përfituesi është i obliguar që të rregullojë hapësirën ku do të vendoset pemishtja.
- 7.3 Hapësira duhet të jetë e pastër të ketë ujë dhe ndriçim të mirë.
- 7.4 Përfituesit nuk i lejohej ta shesë, tjetërsojë ose ta keqpërdor projektin e lartëcekur, në të kundërtën do të ndiqet penalisht.

Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

P A L Ë T E M A R R Ë V E S H J E S

Komuna e Vushtrrisë

Z. Bajram Mtlaku
Kryetar i Komunës



Përfaqësuesit e përfituesve të Pemishtes:

1. Gani Binaku
2. Sejdullah Shala
3. Safet Kelmendi

(Handwritten signatures)



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRA
BESHTETIM Nr. 208/17
Nr. Lq./ Broj
Data/ Datum 02.03.2017
VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË GRUPIT PUNUES

1. Me këtë vendim formohet grupi punues i përbashkët me grupin punues të Komunës Vaxjo – Suedi, për hartim të strategjisë ndërkombëtare, në këtë përbërje:
 - 1.1 Arta Haxhaj, kryesuese e grupit
 - 1.2 Ardi Ukshini, - anëtar
 - 1.3 Islam Latifi - anëtar,
 - 1.4 Nexhat Merovci - anëtar
 - 1.5 Idriz Ismajli - anëtar,
 - 1.6 Haki Maloku – anëtar.
2. Grupi punues në fjalë do të bashkëpunoj me grupin punues të Komunës Vaxjo – Suedi për hartimin e Strategjisë ndërkombëtare për aplikim në fondet e Bashkësisë Evropiane për projekte komunale.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67. „f” dhe „g” të Statutit të Komunës ,neni 22 të Ligjit Nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme dhe nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2011 për ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave administrative për tatimin në pronën e paluajtshme me këtë përbërje :

- 1.1 Sabile Klinaku, kryesuese
- 1.2 Isa Latifi , anëtar
- 1.3 Selim Pllana ,anëtar

2. Komisioni në përbërje të cekur si më lartë do të shqyrtoj dhe do të vendosë lidhur me ankesat administrative për tatimin në pronën e paluajtshme në Komunën e Vushtrrisë konform legjislacionit që është në fuqi .


3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit .

4. Vendimi i dërgohet Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa ; anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë .



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKAE KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

03 Nr. / Nr. 216/17

Nr. i fq. / Br. sh. 3

Data: / Datum 06.03.2017

VUSHTRRI - VUČITRAN



KOMUNA VUSHTRRI

NGO VOICE OF ROMA, ASHKALI AND
EGYPTIANS
GRACANICA NN., 10500 PRISTINA, KOSOVO
INFO@VORAE.ORG; 00377 (0)45 256 665
WWW.VORAE.ORG

Memorandum Bashkëpunimi

në mes

OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasëve
Gracanicë p.n, 10500 Prishtinë, Kosovë

dhe

Komuna e Vushtrrisë
Sheshi "Hasan Prishtina" Nr. 173

Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes

Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasëve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Agjension Implementues – lidhë këtë Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Vushtrrisë si Partnerë me qëllim të bashkëpunimit për Projektin "Përfshirja Sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe grupe të tjera të cenuara në Komunën e Vushtrrisë".

Neni 2

Obligimet e Palëve të Marrëveshjes

2.1 Përgjegjësitë dhe obligimet e OJQ "VoRAE" dhe Komunës Vushtrrisë janë të detajizuara në këtë Memorandum Bashkëpunimi.

Bevan

2.2 Buxheti i paraparë për viti 2017 për qendrën e edukimit në Prelluzhë, Komuna e Vushtrrisë për realizimin e këtij projekti në total është **10.000,00 € (dhjetëmijë euro)** dhe do të shfrytëzohet për:

- 2.2.1 Pagat e tutorëve të qendrave
- 2.2.2 Trajnimet e tutorëve
- 2.2.3 Materialin didaktik
- 2.2.4 Ushqimin e nxënësve gjatë orarit mësimorë
- 2.2.5 Aktivitetet rekreative të nxënësve si dhe
- 2.2.6 Programin verorë.

Neni 3

Obligimet e Agjencisë Implementuese

3.1 Agjencia Implementuese do të zbatoj në tërësi programin për qendrat e edukimit në Prelluzhë të cilat kane për qellim :

- 3.1.1 të përfshijë fëmijët e pa favorizuar në arsimin e rregullt;
- 3.1.2 të zvogëlojë numrin e braktisjeve nga shkollat e rregullta;
- 3.1.3 të rris suksesin e tyre akademik në shkollë dhe në mirëqenien e përgjithshme si dhe
- 3.1.4 të lehtësoje pjesëmarrjen e tyre në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët.

3.2 Agjencia Implementuese do të siguroj mjete financiare në shumë prej 8.000,00 € (tetëmijë euro) për financim të këtij projekti.

3.3 Agjencia Implementuese do të komunikojë me komunën për aktivitetet e kryera në qendrën e edukimit, dhe në rast nevojë të kërkojë ndihmën apo ekspertizën e tyre në mënyrë që të ndihmojnë në procesin e vendim-marrjes dhe mbarëvajtjen e mësimin.

Neni 4

Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

4.1 Komuna, bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës nga mbledhja e mbajtur më 23 shkurt 2017, nga buxheti i saj do të investoj mjete në shumë prej **2.000,00 € (dymijë euro)**.

4.2 Pagesa e mjeteve do të behet si vijon:

4.2.1 Deri në fund të muajit korrik 2017 do të paguhet 1000 € (njëmijë euro) ose 50 % e mjeteve, pas raportimit me shkrim për implementim të suksesshëm të këtij projekti,

4.2.2 Deri në fund të muajit dhjetor 2017 do të paguhet pjesa tjetër në shumë prej 1000 € (njëmijë euro), pas raportimit me shkrim për përfundim të suksesshëm të këtij projekti.

4.3 Komuna do ofroj ndihmë teknike në realizimin e projektit, në formë të bashkëfinancimit.

4.4 Komuna e Vushtrrisë do të përfaqësohet përmes Zyrtarit për Arsim të cilin do ta cakton Drejtori i Drejtorisë për Arsim.

4.5 Komuna do të ndihmojë Agjencinë Implementuese në implementimin e aktiviteteve duke dhënë këshilla për aktivitetet që do të ndërmerren.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe është valide për periudhën kohore Mars – Dhjetor 2017.

Neni 6

Kushtet e Veçanta

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e plotfuqishme që nga dita e nënshkrimit nga të dyja palët.

Neni 7

Kjo marrëveshje është përpiluar për secilën palë nga një ekzemplarë në original.

Komuna e Vushtrisë
06.10.2017
Kosovë

Agjensia Implementuese
06.10.2017
Gracanicë, Kosovë

Bajram Mulaku
Kryetari i Komunës
Komuna e Vushtrisë



Isak Skenderi
Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egypasëve
Drejtore Ekzekutiv





Republika e Kosovës

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUŠTRIN
03 No./Pr. 222/17
No. I fq./Dok. _____
Data / Datim 06.03.2017
VUSHTRIN - VUŠTRIN



Komuna Vushtri

Zyra e Kryetarit të Komunës

Në mbështetje të nenit 58 të ligjit mbi Vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, dhe duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nr.703/2017 të datës 16.02.2017, kryetari i komunës së Vushtrisë, merr këtë:

VENDIM

- I. Obligohet Njësia e Personelit të Komunës së Vushtrisë që ta anulojë procedurën e rekrutimit sipas konkursit të shpallur, më 30.03.2016 të shpallur nga Komuna e Vushtrisë, për pozitën "Zyrtar për Komunitete dhe Mundësi të Barabarta", si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- II. Obligohet Njësia e personelit që këtë vend pune ta shpallë dhe ta rekrutoj konform dispozitave ligjore.
- III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit



Kryetari i Komunës


Bajram Mulaku



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrisë

Kryetari i komunës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenit 12 pika 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 03/L-149, Kryetari i Komunës, bien:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar për vendet e punës: **Kontratë për marrëveshje të veçanta (Pylltar)** në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Komuna Vushtri.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Sabit Mehmeti – kryesues i komisionit
 2. Bujar Pllana – anëtar i komisionit
 3. Jeton Salihu – anëtar i komisionit
3. Komisioni ka për detyrë që ti kontrollojë të gjitha aplikacionet, të intervistojë dhe përzgjedh kandidatët për pozitën e lartcekur.



Kryetari i komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRA	
QZ No./Idr:	223/17
No. i Sp./Dok.	
Data/ Datum:	07.03.2017
VUŠITRI - VUČITRA	



Komuna e Vushtrrisë

Kryetari i komunës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenit 12 pika 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 03/L-149, Kryetari i Komunës, bien:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar për vendet e punës: **Kontratë për marrëveshje të veçanta** (Zyrtar për pranimin dhe përpunimin lëndëve – aplikacioneve që kanë të bëjnë me subvencionet e MBPZHR) në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Komuna Vuçitri.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Rabije Zahiti – kryesues i komisionit
 2. Besim Demiraj – anëtar i komisionit
 3. Jeton Salihu – anëtar i komisionit
3. Komisioni ka për detyrë që ti kontrollojë të gjitha aplikacionet, të intervistojë dhe përzgjedh kandidatët për pozitën e lartcekur.



Kryetari i komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës




Komuna e Vushtrrisë

Kryetari i komunës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenit 12 pika 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 03/L-149, Kryetari i Komunës, bien:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar për vendet e punës: **Kontratë për marrëveshje të veçanta** (Mirëmbajtës të lumit "Tërstena") në Drejtorinë për Shërbime Publike – Komuna Vushtrri.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Arben Mlinaku – kryesues i komisionit
 2. Afrim Fazliu – anëtar i komisionit
 3. Jeton Salihu – anëtar i komisionit
3. Komisioni ka për detyrë që ti kontrollojë të gjitha aplikacionet, të intervistojë dhe përzgjedh kandidatët për pozitën e lartcekur.



Kryetari i komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRA

01 No./br. 237/17

No. llog./br. sh.

Data: / Datum: 07.03.2017

VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj z. **Gëzim Saraçin** Drejtor i Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" në Vushtri që të kujdeset për mbikëqyrje të respektimit të orarit të punës të punëtorëve të kësaj qendre (të gjithë punëtorët e DKRS që punojnë në objektin e QK.) që nënkupton ardhje vajtjet në punë si dhe brenda kohës së qëndrimit në punë.
2. I lartpërmenduri do të i jap raport Drejtoreshës për Kulturë Rini dhe Sport lidhur me të cekurat nën pikën 1 (një) të kësaj urdhërese, ndërsa listat e nënshkrimeve duhet të ia dorëzoj Udhëheqësit të Personelit të Komunës.
3. Orarin e punës për punëtor të Qendrës së Kulturës e cakton Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport në bashkëpunim me drejtorin e Qendrës së Kulturës.
4. Urdhëresa hyn në fuqi dhe do të zbatohet nga dita e nënshkrimit.
5. Urdhëresa i dërgohet: Drejtoreshës për Kulturë Rini dhe Sport, të lartpërmendurit Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRI

02 Nr./Eo 252/17

Nr./Iq./Eo.st _____

Data/ Datum 10.03.2017

VUSHTRRI - VUÇITRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj Drejtorin e Arsimit në Vushtri, Drejtorin e Gjimnazit "Eqrem Qabej", Drejtorin e SHMP "Bahri Haxha" dhe Drejtorin e SMT "Lutfi Musiqi" që me rastin e organizimit të mbrëmjes së maturës për maturant të këtyre shkollave, të ndërmarrin masat e nevojshme për respektim të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës 02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore.
2. Në rast të mosrespektimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ nga pika paraprake përkatësisht të kësaj urdhërese, përgjegjësia do të bie mbi drejtorët e shkollave të sipërshtënuara.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorit për Arsim dhe drejtorëve të tri shkollave të mesme të cekur në pikën një të kësaj urdhërese.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRI

Numri/Identi: 273/17

Data/ Datim: 13.03.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. Me këtë vendim iu lejonet mbushje të telefonisë mobile të Vala-s, anëtarëve të komisionit për ankesa në tatimin në pronën e paluajtshme, të shënuar si në vijim:
 - 1.1 **Sabile Klinaku**, 20,00 € për muajin prill 2017,
 - 1.2 **Isa Latifi**, 20,00 € për muajin prill 2017,
 - 1.3 **Selim Pllana**, 20,00 € për muajin prill 2017,
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës


Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - OPSTINA VUSHTRRI

№ Doku: 290/17

Datë: 13.03.2017

VUSHTRRI - VUSHTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr.25/2017, dt.08.03.2017, në shumë prej 50.00 € (pesëdhjetë euro), për shpenzimet e krijuara - drekë për pjesëmarrës në turneun e volejbollit, organizuar me rastin e shënimit të 8 marsit, Ditës së Gruas.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në numër të llogarisë bankare të Shoqatës së Familjarëve të Martirëve "Martirët e Lirisë" në Vushtri, të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr.24/2017, dt.18.02.2017, në shumë prej 200.00 € (dyqind euro), për shpenzimet e krijuara - drekë për pjesëmarrës në turneun e pingpongut, organizuar me rastin e shënimit të 17 shkurtit, Ditës së Pavarësisë.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në numër të llogarisë bankare të Shoqatës së Familjarëve të Martirëve "Martirët e Lirisë" në Vushtrri, të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRA

02 Nr. / Nr. 302 / 17

Nr. i Zg. / E. n. m

Data / Datum 15.03.2017

VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim formohet grupi punues i përbashkët me grupin punues të Komunës Vaxjo – Suedi për hartimin e strategjisë ndërkombëtare në këtë përbërje:
 - 1.1 Arta Haxhaj, kryesuese e grupit
 - 1.2 Ardi Ukshini, anëtar
 - 1.3 Islam Latifi, anëtar
 - 1.4 Nexhat Merovci, anëtar
 - 1.5 Mirjeta Salihu, anëtar
 - 1.6 Avdullah Sadriu, anëtar
2. Grupi punues në fjalë do të bashkëpunoj me grupin punues të Komunës Vaxjo – Suedi për hartimin e Strategjisë Ndërkombëtare për aplikim në fondet e Bashkësisë Evropiane për projektet komunale.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet e kryetarit të komunës 02nr.208/17, dt. 02.03.2017 dhe 02nr.242/17 dt. 08.03.2017.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet Znj. Arta Haxhaj, kryesuese e grupit me qëllim të njoftimit të Komunës Vaxjo – Suedi dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITAN
Nr. Nr. / No. 316/17
Nr. Tq. / No. 16.03.2017
VUSHTRRI - VUČITAN

REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 12 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në kërkesën nr. 9861/17, dt.02.03.2017 të Drejtorisë për Administratë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pranimi në punë i tre (3) punëtorëve/eve në afat të caktuar për gjashtë (6) muaj, me përgatitje universitare, në formë të ashtuquajtur "Marrëveshje për shërbime të veçanta" që do të punojnë në Drejtorinë për Administratë në Vushtrri në sektorin e gjendjes civile.
2. Obligohet Zyra e Personelit që të zbatoj procedurat e thjeshtëzuara të rekrutimit në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Administratë, Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRAN

02 Nr./Titull: 322 / 17

Nr i titullit: _____

Data: / Datum: 20.03.2017

VUSHTRRI - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Kryetari i komunës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenit 12 pika 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 03/L-149, Kryetari i Komunës, bien:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar për vendet e punës: **Kontratë për marrëveshje të veçanta** (Përkthyes i gjuhës angleze) në **Drejtorinë e Prokurimit – Komuna Vushtrri**.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Xhafer Islami – kryesues i komisionit;
 2. Avdullah Sadriu – anëtar i komisionit;
 3. Jeton Salihu – anëtar i komisionit.
3. Komisioni ka për detyrë që ti kontrollojë të gjitha aplikacionet, të intervistojë dhe përzgjedh kandidatin për pozitën e lartcekur.



Kryetari i komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIŠË - OPŠTINA VUČITRAN

UZ.Nr./Br. 338 / 17

No. i Ep./Br. sh.

Data: / Datum 23.03.2017

VUŠITRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt. 23.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës, njësia buxhetore – Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere (subvencione për aktivitete kulturore rinore sportive), lejohen mjete financiare në shumë prej 400,00 €, (katërqind euro) në llogari të OJQ "Klubi Avokues për Persona me Aftësi të kufizuar – KAPAK" për organizim të aktivitetit dy ditor për persona me aftësi të kufizuar të Komunës së Vushtrrisë.
2. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve. Para nënshkrimit të marrëveshjes, DKRS do të siguroj dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi për të kryer pagesën e mjeteve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRIN	
02 Nr./Bv.	339/17
Nr./Bq./Bc. et	
Data: / Datum	23.03.2017
VUSHTRRI - VUČITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, të Marrëveshjes 02nr. 1146/16 dt.30.11.2016 në mes të Komunës së Vushtrrisë, dhe Fondacionit Agape – Suedi për pranim të donacionit të materialit (30 shtretër dhe materialit tjetër) për nevoja të QKMF-së dhe personave me nevoja të veçanta në Komunën e Vushtrrisë, dhe me propozim të Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoreshës së QKMF-së, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Z. Formohet komisioni për pranim të donacionit nga Suedia – Fondacionit Agape, materiali (30 shtretër dhe materialit tjetër) për nevoja të QKMF-së dhe personave me nevoja të veçanta në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Naim Ferizi**, DSHPS -Vushtri
 - 1.2 **Liridon Hajrizi**, QKMF- Vushtri
 - 1.3 **Mentor Hasani**, QKMF- Vushtri
2. Komisioni në fjalë do të zbatoj me përgjegjësi të gjitha procedurat e nevojshme në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, për pranim sipas listës të mallit të dorëzuar nga donatori si dhe sistemim gjegjësisht shpërndarje të të materialit nga pika një (1) e këtij vendimi bazuar në udhëzimet e Drejtorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale si dhe Drejtoreshës së QKMF-së në Vushtri.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: DSHPS, QKMF, anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, dhe në bazë të vendimit nr.320/17 të datës 20.03.2017, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Administratë- Komuna e Vushtrrisë

Vendet e punës: Zyrtarë të gjendjes civile

Numri i ekzekutuesve: Tre(3)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj, pa mundësi vazhdimi)

Orari i plotë:40 orë në javë

Paga: 291.36 euro bruto

Qëllimi i vendit të punës:

- Ofrimi i shërbimeve për qytetarët në Zyrën e Gjendjes Civile

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- 1.Verifikimi i qytetarëve në regjistrin e themeltar elektronik dhe unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrat themeltar fizik,
2. Mirëmbajtja dhe kujdesi i regjistrit themeltar dhe qendror si në aspektin fizik dhe elektronik dhe të dokumenteve të arkivuara.
3. Përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasve në regjistrin themeltar dhe qendror,
4. Përdorimi dhe zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë me gjendjen civile
- 5 Përdorimi dhe shfrytëzimi i aplikacionit të GJC sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë,
- 6.Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile si lindje,martesa dhe vdekje.

Kualifikimj profesional, aftësitë, përgjegjësitë:

Diplomë universitare

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks.gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, dhe në bazë të vendimit nr.320/17 të datës 20.03.2017, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Kulturë Rini Sport- Komuna e Vushtrrisë

Vendi i punës: Zyrtar për hartimin e guidave dhe strategjisë së turizmit

Numri i ekzekutuesve: Një(1)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj, pa mundësi vazhdimi)

Orari i plotë:40 orë në javë

Paga: 348.56 euro bruto

Qëllimi i vendit të punës:

-Kryerja e punëve rreth turizmit.

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësiave;

1.Hartimi i guidave ,

2. Hartimi i strategjisë së turizmit

3. Të gjitha punët të cilat kanë të bëjnë me turizmin e komunës së Vushtrrisë

Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:

Diplomë universitare;nga lëmi i turizëm, arkitekturë-ndërtimtari ose dizajn

Njohja e mirë e gjuhës angleze;

Njohja e programeve Word dhe Exel;

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRA	
02 Nr. / Dr.	345/17
Nr. l.fq. / Dr. st.	2
Data: / Datum	24.03.2017
VUSHTRRI - VUČITRA	



Komuna Vushtri

Zyra e Kryetarit të Komunës

Në mbështetje nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, në bazë të vendimit të këshillit drejtues të QKMF-ës Vushtri, nr.126 dhe në bazë të rekomandimit nr.224 të datës 09.03.2017 të Departamentit të Buxhetit të MEF-it, Kryetari i Komunës, shpall:

KONKURS

Për vendet e lira të punës:

I.Vendet e punës:Infermier-e

Numri i ekzekutueseve gjashtë(6)

-Një(1)infermier-e në QMF Maxhunaj;

-Një(1)infermier-e në QMF Druar ;

-Një(1)infermier-e në QMF Lumadh;

-Një(1)infermier-e në AMF-Dubovc ;

-Një(1) infermier-e në AMF-Beçiq;

-Një(1)infermier-e në AMF-Stroc;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësiave;

-Pranon dhe triazhon pacientët në QMF ose AMF;

-Përgatit pacientët gjatë vizitës;

-Kryen punët administrative të dokumenteve shëndetësore;

-Përgjigjet për participimin nga pacientët;

-Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës,patronazhit,terenit dhe edukimit shëndetësor;

-Për punën e vet i përgjigjet kryeinfermierit.

Periudha e kontratës: Një(1) vit me mundësi vazhdimi

Koeficienti 4.80

Kualifikimi profesional, aftësitë

-Diploma Universitare –Bachelor ose Diploma e shkollës së mesme të mjekësisë ;

-Licenca e punës

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet të konkurrojnë për vendet e cekura si:QMF-Maxhunaj, QMF-Druar,QMF-Lumadh, Amf-Duboc,AMF-Beçiq, AMF-Stroc.

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës kk.rks-gov.net/vushtri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit të**

dhe certifikatën e lindjes, Licencën,të jenë banor të Republikës së Kosovës,mos të kenë fletëparaqitje penale dhe i dënuar , certifikatën shëndetësore.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon dhe në WEB-faqe të komunës,në afat ligjor.

Mirëpritet aplikimi prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës Kosovës.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI
VUSHTRRI MUNICIPALITY / OPSTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 24.03.2017 merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

Neni 1.

KONSTATOHET se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik-realizimi i projektit për ndërtimin e pushtave për nevojat e fabrikës së ujit në fshatin Balincë, Komuna Vushtrri për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-73, tabela 111, fletëtreguesi 54, në sipërfaqe prej **555 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6695 m², ZK-Akrashticë, me pronar në pjesë ideale 1/1 Hatigje Morina (e veja e Ajetit) nga Akrashtica, Komuna Vushtrri.

Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore "Kosova Sot" në Kosovë.

Neni 4

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, konform nenit 35 par 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. Ankesa mund të paraqitet nga pronari ose

zotërues i interesit në pronën e prekur nga ky vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe në Gazetën ditore "Kosova Sot" në Kosovë.

 Kryetari i Komunës
Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VUSHTRRISË - КОМУНА ВУШТРИ

02 Nr./ No. 349/17

Nr. I fq./ In. sh. 2

Data/ Datum 24.03.2017

VUSHTRRI - ВУШТРИ



REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dt. 28 tetor 2010, dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 24.03.2017, merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. Miratohet shpronësimi për interes publik, realizimin e projektit për asfaltimin e rrugës lokale në Lagjen “Igrishta” në fshatin Stanoc i Poshtëm, Komuna e Vushtrrisë, të pronave të paluajtshme si në vijim:
P-70202053-00207-0, në sipërfaqe prej **30 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1663 m², ZK-Prelluzhë, pronar në pjesë ideale 1/1 Sefedin Rexhep Haradini nga Stanoci i Poshtëm, Komuna Vushtrri.
P-70202053-00208-0, në sipërfaqe prej **10m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1409 m², ZK-Prelluzhë pronar me pjesë ideale 1/1 Izet Brahim Igrishta nga Stanoci i Poshtëm, Komuna Vushtrri.
2. Për pronat e shpronësuara, do të paguhet kompensimi në emër dhe llogari të secilit pronarë të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, apo zotëruesit të interesit, në bazë të akt vlerësimeve të Ministrisë së Financave – Departamentit të Tatimit në pronë dt.28.09.2016.
3. Akt vlerësimet janë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe janë bashkangjitur në shtojcë.
4. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të paguhet në tërësi shuma e kompensimit për pronën e shpronësuar me këtë vendim.
5. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, i njëjti i dërgohet personit prona e të cilit është shpronësuar.

6. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, i njëjti do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Vushtrri.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
9. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të të njëjtit. Ankesa paraqitet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega në Vushtrri dhe ka të bëjë vetëm me kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUŠTRRI	
Nr. / Br. / No.	350/17
No. i fq. / Br. sh.	3
Data / Datum	27.03.2017
VUŠTRRI - VUŠTRRI	

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT NDËRTIMIN E SHTATORES DHE RREGULLIMIN E SHESHIT "HASAN PRISHTINA" NË VUSHTRRI

Palët Nënshkruese

- Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës përfaqësuar nga Drejtori i Agjencisë z. Idriz Blakaj (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), dhe
- Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Bajram-Mulaku (në tekstin e mëtejshëm Komuna),

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVO	
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës	
Agency for Management of Memorial Complexes of Kosovo	
Nr./Br.No.	53.03.17
Data/Datum/Date	27.03.2017
PRISHTINE - PRISHTINA	

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i përbashkët i projektit "Ndërtimi i Shtatores dhe sheshit "Hasan Prishtina" në Vushtrri dhe përcaktimi i obligimeve të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Komunës së Vushtrrisë për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e financimit

Projekti "Ndërtimi i Shtatores dhe sheshit Hasan Prishtina" në Vushtrri ka vlerë paralogaritare në shumë prej 340,000.00 € (treqindekatërdhjetëmijë euro)

Neni 3 Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

3.1 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës i zoton mjetet financiare në shumë prej 250,000.00 € (dyqindpesëdhjetëmijë euro) për projektin nga neni 2 i kësaj Marrëveshje.

3.2 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës merr përsipër që projektin Ndërtimi i Shtatores dhe sheshit "Hasan Prishtina" në Vushtrri ta realizoj në pajtim me dispozitat në fuqi për Prokurimin Publik me ndryshimet dhe plotësimet e tij, Ligjit për

Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi në fuqi me ndryshimet dhe plotësimet e tij si dhe aktet nënligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje.

3.3 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës kryen procedurat e tenderimit për sheshin dhe për shtatore, cakton komisionin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

3.4 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës cakton menaxherin /organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/ pranimin teknik.

3.5 Menaxheri i projektit/ organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës. Procedura e pagesës e njëjta vlen edhe për pjesën e obligimeve që ka komuna (për pjesën e mjeteve prej 90,000.00€, pagesa e kësaj shume do te kryhet ne tri këste).

3.6 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës vendos në vend punishte tabelën informuese (Pano) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

3.7 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2017. Pas këtij afati të gjitha obligimet mbesin në përgjegjësi të Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

3.8 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do ta njoftoj Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani një mujor deri në përfundimin e projektit.

Neni 4 Obligimet e Komunës

4.1 Komuna e Vushtrisë i zoton mjetet financiare në shumë prej **90,000.00 €** (nëntëdhjetëmijë euro) për projektin nga neni 2 i kësaj Marrëveshje.

4.2 Komuna është e obliguar që brenda 30 ditëve nga pranimi i marrëveshjes së mirëkuptimit të nënshkruar dhe protokolluar të sjellë në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, projektin zbatues si dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm i cili siguron se projekti nuk do të sjellë pengesa në realizim. Komuna e Vushtrisë do të fillon me procedurat e sigurimit të zotimit të mjeteve të parapara me këtë marrëveshje dhe një kopje të këtij zotimi e sjell bashkë me deklaratën e mjeteve.

4.3 Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së përcaktuar në pikën 4.1 të kësaj marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

4.4 Komuna cakton një zyrtar i cili do të jetë pjesë e komisionit për vlerësim të ofertave për shtatore një zyrtar i cili do të jetë pjesë e komisionit mbikëqyrës dhe një zyrtar tjetër që do të jetë pjesë e komisionit për pranim teknik të projektit.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

5.1 Me pëlqimin paraprak të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

5.2 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbushë obligimet e veta nga kjo marrëveshje.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim.

Neni 7

Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër kopje, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Neni 8

Pronësia e projektit

8.1 Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik ky projekt nga kjo marrëveshje do të kalojë me automatizëm në pronësi të Komunës së Vushtrrisë.

8.2 Ky projekt regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë fizike dhe elektronike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 9

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

AMKMK

Idriz Blakaj, Drejtör



Komuna Vushtrri

Bajram Mulaku, Kryetar



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUČITAN	
Nr. / Br.	357 / 17
Nr. / fq. / Br. sh.	
Data / Datum	28.03.2017
VUSHTRRI - VUČITAN	



Komuna Vushtrri

Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari merr këtë :

VENDIM

1. Në mungesë të mjeteve financiare në Drejtorinë për Shërbime Publike nën programi Infrastrukturë publike në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në kodin ekonomik; regjistrim i automjeteve dhe sigurim i automjeteve, lejohet pagesa e mjeteve nga nënprogrami Zjarrfiksat nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve në kodin ekonomik regjistrim i automjeteve dhe sigurim i automjeteve.
2. Për zbatimin e këtij vendimi duhet të kujdeset Drejtoria për Buxhet Thesar e Financa
3. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit .
4. Vendimi i dërgohet : Drejtorisë për Buxhet Thesar e Financa, Drejtorisë për Shërbime Publike, nënprogrameve Infrastruktur Publike dhe nënprogramit të Zjarrfiksave.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, në bazë të nenit 3 të Rregullores për rekrutimin e nëpunësve civil, nr.02/2010, Kryetari i komunës, shpall:

KONKURS

Drejtoria për Arsim

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë - AR/530 / JP00028370

Numri i ekzekutuesve: Një(1)

Lloji i pozitës: I karrierës

Orari i plotë: 40 Orë në javë

Kategoria funksionale: Profesionale

Grada e vendit të punës 9

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Qëllimi i vendit të punës: Hartimi, zhvillimi dhe mbikëqyrja e legjislacionit, politikave, procedurave standarde për sigurimin e cilësisë së arsimit të mesëm të lartë, si dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve në këtë nivel të arsimit, duke punuar me mbikëqyrje të kufizuar

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Analizon legjislacionin, politikat dhe procedurat lidhur me arsimin e mesëm të lartë dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve cilësorë si dhe zhvillimin dhe realizimin e reformave arsimore;
3. Harton dhe zhvillon legjislacionin, politikat, strategjitë dhe procedurat standarde si dhe përcakton dokumentacionin shkollor për arsimin e mesëm të lartë;
4. Monitoron mbarëvajtjen, dhe zhvillimin e edukimit dhe arsimit dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit ;
5. Mbështet dhe këshillon institucionet e arsimore për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve në arsimin e mesëm të ulët;
6. Identifikon dhe analizon nevojat për trajnime në arsimin e përgjithshëm dhe koordinon punën me zyrën e trajnimeve për organizimin e trajnimeve për e mësimdhënësit;
7. Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit dhe strategjive për arsimin e mesëm të lartë dhe harton raporte periodike për procesin e zbatimit të legjislacionit dhe strategjive;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

Diploma universitare , minimum 2 vite përvojë pune profesionale

Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit

Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin

Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

Vërejtje: Dokumentacioni nuk kthehet, çdo dokument duhet të jetë i fotokopjuar.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisni: **Kopjen e Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës-së Kosovës".



Bajram Mulaku

Kryetar i komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

Uz. No. / Uz. _____ 388/17

No. Kq. / Gr. K _____

Data: / Datum _____ 31.03.2017

VUSHTRARI - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 pika „f” dhe „g” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 58/11 datë 28/04/2011 ;Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M
Për formim të komisionit

1.Me qëllim të verifikimit të dhënave për pagesë të kontributeve në emër të veprimtarisë së ushtruar zeytare nga zeytarët privat të komunës për periudhën kohore të para luftës në Kosovë formohet komisioni profesional në këtë përbërje :

- 1 Gani Sylja, kryesues i komisionit
- 2 Bedri Kostanica , anëtar i komisionit
- 3 Mexhit Perquku ,anëtar i komisionit

2.Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi ka për detyrë të shqyrtoj kërkesat e palëve dhe të verifikoj të dhënat lidhur me pagesën e kontributeve të tyre me rastin e ushtrimit të veprimtarive zeytare për kohën deri në fillimin e luftës në Kosovë (1998-1999) dhe të japë dëshmi me shkrim në bazë të Ligjit në fuqi ,palëve të interesuara për realizimin e të drejtave të tyre për pension.

3.Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit .

4.Komisioni në fjalë ,për punën e tij do ti raportoj me shkrim Kryetarit të Komunës duke e njoftuar për secilin raste të dhënies së dëshmisë për çështjen e cekur më sipër.

5.Nga një kopje e këtij vendimi i dërgohet secilit anëtar të komisionit me qëllim të njoftimit ,ndërsa origjinali mbetet në arkivin e sekretarisë .



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku